

Indeksi i Çmimeve të Konsumit


Dhjetor 2023

Tiranë, më 10 Janar 2024: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Dhjetor 2023, arriti 115,8 kundrejt muajit Dhjetor 2020.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2023 është 4,0 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 7,4 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Dhjetor 2023, krahasuar me Nëntor 2023 është 0,5 %.

Rritja mesatare vjetore e çmimeve në vitin 2023 është 4,8 % nga 6,7 % që ishte në vitin 2022.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Dhjetor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +2,38 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,51 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me +0,34 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” me +0,21 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” me +0,20 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Argëtim dhe kulturë” me +0,13 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” me +0,11 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shërbimi arsimor” me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Shëndeti” me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Komunikimi” me +0,01 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,21 pikë përqindje.

Për publikim 10/01/2024

Fig.2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Dhjetor 2022, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 6,7 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 5,4 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 4,6 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 4,4 %, “Pije alkoolike dhe duhan” me 4,3 %, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 3,4 %, “Veshje dhe këpucë” me 3,0 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 2,6 %, “Shërbimi arsimor” me 2,3 %, “Shëndeti” me 1,2 % dhe “Komunikimi” me 0,3 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” shënuan ulje me 3,3 %.

Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 20,8 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 10,9 %, “qumësht, djathë dhe vezë” me 6,7 %, “mish” me 5,5 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata dhe mbëlsira” me 2,7 %, “peshk” me 2,4 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Nëntor 2023, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 1,1 %, pasuar nga grupet “Pije alkoolike dhe duhan” me 1,0 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,6 %, “Veshje dhe këpucë” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,5 % secili, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,2 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Shëndeti” me 0,1 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 2,1 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23	12-23
	Gjithsej	100	111,4	112,6	113,9	114,7	114,7	114,3	114,0	113,8	114,5	115,3	115,4	115,3	115,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	35,6	121,4	124,5	128,7	130,8	130,5	129,0	127,4	126,7	127,2	128,7	128,7	128,1	129,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	4,9	107,7	108,2	108,6	109,2	109,8	110,3	110,3	110,8	110,8	111,0	111,2	111,2	112,4
3	Veshje dhe këpucë	3,6	105,6	105,5	105,3	105,3	105,4	105,8	106,2	106,7	106,6	107,5	108,1	108,2	108,7
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	19,5	104,8	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	105,4	105,4	106,6	106,6	106,7	106,8	107,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	7,4	107,7	108,0	108,7	109,3	110,3	110,7	111,0	111,2	111,6	112,0	112,8	112,5	112,6
6	Shëndeti	4,2	102,0	101,9	102,0	102,0	102,2	102,2	102,3	102,5	102,7	103,0	103,1	103,1	103,2
7	Transporti	6,4	115,6	116,4	113,1	112,0	110,7	109,3	109,0	109,8	112,8	114,3	114,6	114,3	111,8
8	Komunikimi	3,1	104,6	104,6	104,6	104,7	104,9	104,9	104,9	104,9	104,9	105,0	105,0	104,9	104,9
9	Argëtim dhe kulturë	2,3	105,6	106,0	106,3	108,0	108,5	109,9	111,8	110,8	110,9	112,3	112,3	111,3	111,3
10	Shërbimi arsimor	3,0	102,8	102,9	102,9	102,8	102,9	103,0	103,0	103,0	103,2	104,9	105,2	105,2	105,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	4,5	108,7	109,4	109,5	110,0	110,4	111,4	111,8	112,5	113,0	113,0	113,3	113,3	113,5
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	5,5	103,0	103,3	103,6	103,9	104,6	105,0	105,2	105,4	105,6	105,9	105,9	106,0	106,6

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	12-22/12-21	01-23/01-22	02-23/02-22	03-23/03-22	04-23/04-22	05-23/05-22	06-23/06-22	07-23/07-22	08-23/08-22	09-23/09-22	10-23/10-22	11-23/11-22	12-23/12-22
	Gjithsej	7,4	7,2	7,1	5,3	4,6	4,7	4,5	4,2	4,0	4,1	3,8	3,9	4,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	14,2	13,3	13,5	11,0	9,6	10,0	10,3	9,0	7,8	7,9	7,4	7,1	6,7
2	Pije alkoolike dhe duhan	5,5	5,1	5,1	2,8	3,8	3,7	3,7	3,8	3,2	3,0	3,6	3,5	4,3
3	Veshje dhe këpucë	3,8	4,1	4,4	3,7	3,9	4,2	4,4	4,3	4,4	3,2	3,2	2,9	3,0
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	2,8	3,0	3,1	2,6	2,3	2,2	2,1	1,3	2,3	2,1	1,6	1,9	2,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,5	6,4	6,9	6,6	6,7	6,5	6,2	6,0	5,9	5,4	5,2	4,8	4,6
6	Shëndeti	1,1	1,0	1,0	1,1	1,4	1,4	1,2	1,1	1,3	1,4	1,1	1,0	1,2
7	Transporti	6,0	6,5	1,7	-7,5	-10,7	-12,3	-16,2	-12,4	-10,0	-7,2	-8,3	-4,0	-3,3
8	Komunikimi	1,3	1,3	1,2	1,4	1,2	1,2	1,4	1,2	1,1	1,1	1,1	0,5	0,3
9	Argëtim dhe kulturë	1,3	1,8	3,4	4,7	2,4	6,9	10,3	9,5	3,9	4,9	7,6	6,0	5,4
10	Shërbimi arsimor	2,3	2,3	2,3	2,0	2,1	2,2	2,2	2,0	2,2	2,3	2,9	2,6	2,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	5,2	5,6	5,5	4,6	4,5	5,0	4,8	5,0	5,0	4,7	4,8	4,3	4,4
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	3,3	3,6	3,2	3,2	3,6	4,0	4,0	3,7	3,7	3,1	2,9	2,8	3,4

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	12-22	01-23	02-23	03-23	04-23	05-23	06-23	07-23	08-23	09-23	10-23	11-23	12-23
	Gjithsej	0,4	1,1	1,1	0,7	0,0	-0,3	-0,3	-0,1	0,6	0,7	0,1	-0,2	0,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	1,5	2,6	3,3	1,7	-0,2	-1,2	-1,2	-0,6	0,4	1,1	0,0	-0,4	1,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,2	0,5	0,3	0,6	0,5	0,4	0,0	0,4	0,0	0,2	0,2	0,0	1,0
3	Veshje dhe këpucë	0,3	-0,1	-0,2	0,0	0,1	0,5	0,4	0,4	-0,1	0,8	0,5	0,2	0,5
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,2	0,0	0,0	1,1	0,0	0,1	0,1	0,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,3	0,3	0,7	0,6	0,9	0,3	0,3	0,2	0,3	0,4	0,6	-0,2	0,1
6	Shëndeti	-0,1	-0,1	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,2	0,2	0,3	0,0	0,0	0,1
7	Transporti	-2,8	0,7	-2,8	-1,0	-1,1	-1,2	-0,3	0,7	2,8	1,3	0,3	-0,3	-2,1
8	Komunikimi	0,2	0,0	0,0	0,1	0,2	0,0	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	-0,1	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	0,5	0,4	0,3	1,6	0,5	1,2	1,8	-0,9	0,1	1,2	0,0	-0,9	0,0
10	Shërbimi arsimor	0,4	0,0	0,0	-0,1	0,1	0,1	0,0	0,0	0,2	1,7	0,3	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,6	0,2	0,4	0,4	0,9	0,3	0,6	0,4	0,0	0,2	0,0	0,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	-0,1	0,2	0,3	0,3	0,6	0,4	0,2	0,2	0,2	0,3	0,0	0,1	0,5

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2021.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mbliidhen çmimet.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit duke filluar nga muaji Janar 2021 llogaritet me bazën e re. Muaji Dhjetor 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (Dhjetor 2020 = 100).

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.